

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

INXHINIERI INFORMATIKE SOFTWARESH

Niveli IV i KSHK

(Bllok 4 vjeçar)

Kodi: T/1-IV-24

(Përgatitur me mbështetjen e Agjencisë Austriake
për Arsim dhe Ndërkombëtarizim)

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2024

Përmbajtja

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh” niveli IV i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike dhe praktike profesionale.

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me punimet dhe shërbimet në Inxhinieri Informatike Softwaresh”*. Zhvillimi të nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtijshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh” niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MEKI përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK.

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwresh”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të hartojë plane dhe strategji të proceseve të biznesit, me anë të sistemeve të teknologjisë së informacionit e komunikimit.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Të interpretojë proceset dhe modelet e proceseve, nga ana menaxheriale në sisteme hardware dhe software.
- Të përzgjedhë komponentë fizikë sipas kërkesave të sistemit kompjuterik.
- Të zhvillojë metodat dhe instrumentet përkatëse në fushën e programimit.
- Të bëjë përzgjedhjen e sistemeve të operimit, platformave, librarive, framework-eve dhe gjuhëve përkatëse të programimit.
- Të formulojë algoritme të thjeshta rekursive duke i konvertuar ato në programe;
- Të testojë algoritmet mbi sistemet e zbatuara për aplikacionet.
- Të konvertojë programe të thjeshta në gjuhë programimi të orientuara nga objektet.
- Të krijojë programe komplekse të orientuara nga objektet duke integruar komponentë software-sh të ndryshëm e të gatshëm.
- Të krijojë programe për aplikimet me ndërfaqe (*user interface*) grafike të përdoruesve.
- Të krijojë software për platforma të ndryshme.
- Të krijojë ndërfaqe komplekse përdoruesish duke patur parasysh aspektin e përdorueshmërisë (*usability*);

- Të krijojë sisteme softwaresh komplekse ndërplatformore (cross-platform) për një funksionim produktiv.
- Të realizojë projekte të thjeshta dhe komplekse mbi *e-commerce* dhe planifikim sistemi, sipas strukturave të biznesit.
- Të konfigurojë rrjete komplekse sipas kërkesave dhe të vlerësojë teknologjitë dhe komponentët e përdorur.
- Të zbatojë mënyrat e operimit të rrjetit sipas funksioneve të menaxhimit.
- Të zbatojë sisteme të thjeshta të shpërndara mbi bazën e performancës.
- Të realizojë dhe testojë sisteme të shpërndara të bazuara në server.
- Të simulojë masa gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e rrjeteve dhe sistemeve.
- Të ndërtojë faqe *web*-i duke përdorur gjuhët e programimit, libraritë dhe *framework*-et përkatëse.
- Të zbatojë funksionet kryesore të programeve aplikative.
- Të krijojë dhe manipulojë skedarët multimediale.
- Të krijojë sisteme bazash të dhënash.
- Të manipulojë sisteme bazash të dhënash.
- Të administrojë sisteme bazash të dhënash.
- Të zbatojë politika të aksesit të përdoruesve në baza të dhënash.
- Të identifikojë problemet e operimit të aplikacioneve dhe të përpunojnë strategji zgjidhjeje;
- Të konfigurojë rrjeta të përmasave të ndryshme.
- Të konfigurojë protokollet e komunikimit në rrjet.
- Të monitorojë parametrat dhe performancën e rrjetit.
- Të kryejë virtualizimet në rrjet.
- Të ngrejë makina virtuale për të provuar hakerimin dhe për të testuar mbrojtjen e sistemit.
- Të zbatojë politikat e sigurisë për mbrojtjen e rrjeteve dhe sistemeve.
- Të përdorë *SQL Injections* për të gjetur bazat e të dhënave, tabelat dhe të dhënat sensitive.
- Të zbatojë algoritmet bazë të *Machine learning*.
- Të përdorë teknikat e Inteligjencës Artificiale (*IA*) në aspekte të ndryshme.
- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe standardet që lidhen me veprimtarinë në kuadrin e informatikës softuerike
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në pune dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional për inxhinieri informatike softwaresh. Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si teknik i inxhinierisë informatike softwaresh në veprimtari supporti teknik, programimi – *frontend* dhe *backend*, për *web* dhe *mobile applications*, *data warehouse*, programim për biznes dhe industri, në kompani për TIK, *Internet Service Provider*, telekomunikacion, *call center*, *helpdesk*, projekte zbatimi për TIK, në institucione që përdorin TIK etj. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e informatikës së software-ve.

Me mbarimin e arsimit profesional në drejtimin “Inxhinieri Informatike Softwaresh” në nivelin IV i KSHK, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, Niveli IV i KSHK					
Lëndët	Klasat/orët javore				Orët totale
	10	11	12	13	
A. Lëndët e kulturës së përgjithshme	18	16	14	11	59
1. Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	2	2	2	8
2. Gjuhë e huaj - Anglisht	3	3	3	2	11
3. Gjuhë e huaj – Gjermanisht	2	2	2	2	8
4. Histori	1	2	-	-	3
5. Matematikë	3	3	3	-	9
6. Fizikë	2	1	-	-	3
7. Kimi	1	1	-	-	2
8. Biologji	-	-	2	-	2
9. Edukim fizik	2	1	2	1	6
10. Shkenca sociale	2	1	-	-	3
11. Gjeografi	-	-	-	2	2
12. Matematikë e avancuar	-	-	-	2	2
B. Lëndët teorike dhe praktike profesionale (Kodi)	16	18	21	23	78
1. Bazat e sipërmarrjes (L-17-157-22)	-	-	2	2	4
2. Mjedis dhe zhvillimi i qëndrueshëm (L-05-198-12)	-	-	-	1	1
3. Menaxhimi (L-17-678-24)	-	2 (1)	2 (1)	-	4
4. Arkitektura kompjuterike (L-26-679-24)	2 (1)	-	-	-	2
5. Sistemet operative (L-26-680-24)	2 (1)	1(1)	-	-	3
6. Programet aplikative (L-26-681-24)	3 (2)	-	-	-	3
7. Programimi dhe inxhinieria e softuerit (L-26-682-24)	5 (3)	5 (3)	5 (3)	5 (3)	20
8. Bazat e të dhënave (L-26-683-24)	-	2 (1)	4 (2)	3 (2)	9
9. Sisteme rrjetesh (L-26-684-24)	-	3 (2)	3 (2)	-	6
10. Siguria kibernetike (L-26-685-24)	-	-	-	3 (2)	3
11. Planifikimi i sistemit dhe zhvillimi i projektit (L-26-686-24)	-	2	5 (2)	6 (3)	13
12. Zhvillim <i>website</i> dhe <i>cloud computing</i> (L-26-687-24)	4 (3)	3 (2)		-	7
13. Shkenca e të dhënave dhe inteligjenca artificiale (L-26-688-24)	-	-	-	3 (1)	3
Gjithësej orët javore	34	34	35	34	137
Puna e diplomës (klasa e katërt)	-	-	-	+	-
Praktikë e detyrueshme në biznes	8 javë gjatë periudhës jo mësimore				

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, 11 dhe 12 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (32 javë mësimore + 1 javë për Provimet Përfundimtare të Nivelit + 3 javë për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 35 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 2 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët teorike-praktike të kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike dhe praktike profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e atyre, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve teorike dhe praktike dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues, si dhe Njesisë së Zhvillimit të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Inxhinieri Informatike Softwaresh”.

Praktika e detyrueshme në biznes, që zhvillohet gjatë periudhës jo mësimore, është një veprimtari shumë e rëndësishme që ndihmon në përvetësimin e plotë të njohurive dhe shprehive profesionale të fituara në shkollë, si dhe integrimin e tyre me qëndrimet e duhura

profesionale, në mjedise pune reale. Bashkëpunimi dhe mbështetja e biznesit për realizimin e plotë të praktikës së detyruar në biznes, janë faktorë themelorë në arritjen e objektivave të kësaj praktike.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike/praktike profesionale bëhet nga vetë mësuesit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota ($4 \div 10$) si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës 13, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve përfundimtare të mëposhtme:

- a) Provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale;
- b) Provimeve Përfundimtare të Nivelit:
 - (i) Provimit të punimit të diplomës;
 - (ii) Provimit për lëndën “Programimi dhe inxhinieria e softuerit”;
 - (iii) Provimit për lëndën “Sisteme rrjetesh”.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të njohurive të përgjithshme, njohurive të profesionit dhe të kompetencave profesionale të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që kryhen në fushën e inxhinierisë informatike softuerike.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Inxhinieri Informatike Softwaresh”, niveli IV i KSHK (referuar nivelit IV të KEK), shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, me Çertifikatën e aftësisimit profesional dhe me Suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sipas modelit të miratuar nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme dhe lëndët profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale
 - rezultatet e provimeve përfundimtare të nivelit.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike dhe praktike profesionale.

1. LËNDA: Bazat e sipërmarrjes (136 orë mësimore)

Kodi: L-17-157-22

Klasa 12: 2 orë në javë x 36 javë = 72 orë mësimore

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror;
- përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve;
- analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse;
- bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme;
- zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to;
- mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme;
- përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup;
- analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore;
- planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj;
- përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme;
- përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit digjital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes;
- përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale;
- përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj;
- përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve;
- përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje;
- përshkruajnë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës;

2. Përmbajtjet:

- Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes.
- Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse.
- Vetvlerësimi i potencialit personal.

- Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive.
- Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja.
- Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve.
- Etika e komunikimit dhe negocimit.
- Puna individuale dhe puna në grup.
- Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi.
- Përgjegjësia individuale dhe shoqërore.
- Menaxhimi eficient i burimeve.
- Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes.
- Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale.
- Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale.
- Format e organizimit të sipërmarrjeve.
- Konteksti i sipërmarrjeve.
- Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve.
- Marrëdhëniet e punës.
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës.
- Vizitë studimore në një sipërmarrje të suksesshme.

Klasa 13: 2 orë në javë x 32 javë = 64 orë mësimore

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve;
- bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit;
- përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi;
- zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit;
- konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi;
- përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi;
- analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi;
- kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi;
- llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi;
- analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes ;
- analizojnë rolin dhe teknikat e sipërmarrjes elektronike në veprimtarinë e bizneseve;
- përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet;
- analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to;

2. Përmbytjet:

- Etika dhe komunikimi në biznes.
- Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve.
- Hartimi i planit të biznesit.
- Procedurat e regjistrimit të biznesit.

- Struktura organizative dhe personeli i biznesit.
- Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore.
- Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve.
- Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit.
- Buxhetimi në biznes.
- Marketingu dhe shitjet në biznes.
- Sipërmarrja elektronike (*e-commerce*).
- Veprimet individuale me bankat.
- Siguracionet personale;

2. LËNDA: Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm (32 orë mësimore) Kodi: L-05-198-12).

Klasa 13: 1 orë në javë x 32 javë = 32 orë mësimore

1. Njohuritë dhe Shprehjetë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”;
- shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”;
- tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues;
- përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor;
- analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor;
- tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor;
- përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit;
- hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor;
- planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor;

2. Përmbytjet:

- Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor.
- Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.
- Zhvillimet demografike dhe mjedisi.
- Shoqëria e konsumit dhe mbetjet.
- Monitorimi i burimeve mjedisore.
- Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.
- Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal.

Klasa 11: 2 orë në javë x 36 javë = 72 orë mësimore (36 orë Teori dhe 36 orë Praktikë)

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- analizojnë kuptimin për sistemet ekonomike dhe mjedisin e veprimit të tyre
- tregojnë çfarë janë kompanitë
- përshkruajnë veçoritë e mjedisit të biznesit
- përpilojnë kontrata sipas llojeve dhe veçorive të tyre
- analizojnë tiparet e të drejtës korporative dhe format juridike përkatëse
- tregojnë si është organizimi strukturor, operacional dhe procesor i bizneseve
- ndërtojnë organogramën e një biznesi tipik
- përshkruajnë modelet organizative të bizneseve
- interpretojnë rregullat funksionimit të biznesit
- bëjnë vlerësimin e aktivëve dhe të kapitalit të biznesit
- bëjnë dallimin midis pagaës dhe mëditjes
- shpjegojnë detyrimet statutore
- përshkruajnë procedurat e aplikimit për punësim
- përshkruajnë procedurat e fillimit të punësimit
- përshkruajnë procedurat e përfundimit të punësimit
- tregojnë çfarë janë burimet njerëzore të një kompanie, japin shembuj
- argumentojnë rëndësinë dhe tregojnë metodat e zhvillimit të vazhdueshëm të personelit
- analizojnë faktorët për planifikimin e karrierës
- analizojnë ndikimin e një mjedisi të shëndetshëm të punës, për suksesin e biznesit
- tregojnë rolin dhe mënyrat e motivimit të personelit.

2. Përmbajtjet:

- Sistemet ekonomike dhe mjedisi i veprimit të tyre
- Kompanitë dhe mjedisi i biznesit
- Kontratat, llojet dhe veçoritë e tyre
- Bazat e të drejtës korporative, format juridike
- Organizimi strukturor, operacional dhe procesor
- Modelet organizative, rregullat e biznesit
- Vlerësimi i aktivëve dhe kapitalit
- Pagat dhe mëditjet, detyrimet statutore
- Aplikimi, fillimi dhe përfundimi i punësimit
- Burimet njerëzore, zhvillimi i personelit, planifikimi i karrierës
- Mjedisi i shëndetshëm i punës, motivimi i personelit

Klasa 12: 2 orë në javë x 36 javë = 72 orë mësimore (36 orë Teori dhe 36 orë Praktikë)

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- tregojnë çfarë janë e drejta tregtare dhe e drejta kolektive e punës

- përshkruajnë si bëhet krijimi i shoqërive tregtare
- japin shembuj për kërkesat ligjore për krijimin e shoqërive tregtare
- përshkruajnë metodat e menaxhimit të shoqërive tregtare
- analizojnë rolin e lidershit në suksesin e shoqërive tregtare
- tregojnë procedurat për blerjet, magazinimin dhe shitjet
- plotësojnë formate të faturave për blerjet, magazinimin dhe shitjet
- analizojnë rregullat e kontabilizimit në një shoqëri tregtare
- tregojnë se çfarë përmban bilanci vjetor dhe libri i firmës
- plotësojnë formate të bilancit vjetor dhe librit të firmës
- analizojnë funksionet operative të kompanive prodhuese
- përkufizojnë dhe japin shembuj për kapitalin e kompanisë dhe kapitalin e huaj
- tregojnë se çfarë janë investimet dhe llojet e investimeve
- japin shembuj të financimit të brendshëm dhe financimit të jashtëm
- përkufizojnë konceptet për asetet, shpenzimet, të ardhurat dhe fitimet
- japin shembuj për asetet, shpenzimet, të ardhurat dhe fitimet
- bëjnë përlllogaritjet e shpenzimeve, blerjeve dhe shitjeve për një kompani të simuluar
- shpjegojnë parimet themelore të teorisë tatimore
- japin shembuj të llojeve të ndryshme të taksave dhe tatimeve
- përshkruajnë elementet përbërëse të bilancit vjetor të kompanisë
- analizojnë parimet e të drejtës dhe veçoritë e të drejtës së personit
- analizojnë parimet e mbrojtjes së konsumatorit
- tregojnë veçoritë e proceseve gjyqësore civile
- analizojnë situatat dhe japin shembuj për krizat e kompanive
- tregojnë mënyrat e menaxhimit të krizave të kompanive
- përshkruajnë procedurat e bashkimit dhe mbylljes së kompanive

2. Përmbajtjet:

- E drejta tregtare, e drejta kolektive e punës
- Formimi i shoqërive tregtare
- Metodatat e menaxhimit, liderशिpi
- Blerjet, magazinimi, shitjet
- Përpunimi i faturave, kontabilizimi
- Bilanci vjetor, libri i firmës
- Kompanitë prodhuese, funksionet operative
- Kapitali i kompanisë, kapitali i huaj
- Investimet, format, financimi i brendshëm dhe i jashtëm
- Asetet, shpenzimet, të ardhurat dhe fitimet
- Përlllogaritjet e shpenzimeve, blerjeve dhe shitjeve
- Teoria tatimore, llojet e taksave dhe tatimeve
- Bilancet vjetore
- Baza e të drejtës, e drejta e personit
- Mbrojtja e konsumatorit, proceset gjyqësore civile
- Krizat e kompanive, menaxhimi i krizave
- Bashkimi dhe mbyllja e kompanive

Klasa 10: 2 orë në javë x 36 javë = 72 orë mësimore (36 orë Teori + 36 orë Praktikë)**1. Njohuritë dhe Shprehitë:**

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- përshkruajnë evolucionin e pajisjeve kompjuterike: mainframe, minikompjuterë, kompjuterë personalë, smartfonë dhe tableta;
- identifikojnë dhe përshkruajnë laptop-et dhe lloje të tjera pajisjesh të lëvizshme së bashku me karakteristikat e tyre;
- shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin i kompjuterit;
- shpjegojnë ndërtimin dhe funksionet e motherboard-it dhe pjesët përbërëse të tij. (*chip sets, bus speeds, socket types, expansion slots, memory slots etj*);
- identifikojnë dhe shpjegojnë procesorët dhe karakteristikat e tyre, përfshirë sistemin e ftohjes (*Socket types, speed, number of cores, power consumption, cache, front side bus, 32 bit versus 64 bit, CPU-Central Processing Unit, fan, case fan etj*);
- identifikojnë dhe shpjegojnë llojet dhe karakteristikat e memorieve ROM (*Read-Only Memory*) e RAM (*Random Access Memory*) SODIMM (*Small Outline Dual In-line Memory Module*), DDR3 (*Dynamic Random-Access Memory 3*), PC100 (*Personal Computer*), PC133, PC2700, PC3200, DDR3-1600, DDR2-667, *single channel & dual channel, memory speed, cache etj*);
- identifikojnë dhe shpjegojnë llojet dhe tiparet e kartave përshtatëse (*Graphic card, sound card, TV tuner, modem card, storage controller, RAID (Redundant Array of Inexpensive Disks) card, eSATA (External Serial Advanced Technology Attachment) card, wired, wireless network cards, capture card, I/O(Input/Output) cards etj*);
- identifikojnë dhe shpjegojnë hard disqet dhe llojet e tjera të pajisjeve të ruajtjes (*Media reader, SATA (Serial Advanced Technology Attachment), eSATA, RAID, USB (Universal Serial Bus), CD/DVD(Compact Disc/Digital Versatile Disc), Blu-ray, IDE, EIDE (Enhanced Integrated Drive Electronics), SCSI (Small Computer System Interface), removable, external etj*);
- përzgjedhin ndërfaqet sipas karakteristikave përkatëse (*USB 1.0,/USB 2.0, seriale, paralele, IEEE (Institute of Electrical and Electronics Engineers)1234 etj*);
- identifikojnë dhe shpjegojnë karakteristikat e pajisjeve kryesore periferike;
- instalojnë, konfigurojnë dhe mirëmbajnë lloje të ndryshme printerash, skanerash dhe video projektorë;
- përzgjedhin komponentë për funksione të caktuara dhe gjykojnë nëse sistemet kompjuterike janë të përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të caktuara;
- montojnë dhe zgjerojnë sisteme kompjuterike;
- identifikojnë dhe zëvendësojnë komponentë e gabuar/me probleme;

2. Përmbajtjet:

- Llojet e kompjuterave, mainframe, minikompjuterë, kompjuterë personalë, smartfonë dhe tableta.
- Laptopët dhe pajisjet e tjera të lëvizshme.

- Ndërtimi dhe funksionimi i kompjuterit.
- Shfaqja e informacionit të brendshëm kompjuterik.
- Pjesët përbërëse të kompjuterit.
- Struktura e Motherboard-it dhe furnizimi me energji.
- Procesorët.
- Kartat shtesë.
- Hard disqet dhe pajisjet ruajtëse *SATA, PATA (Parallel Advanced Technology Attachment), RAID, HDD (Hard Disk Drive) masterslave*. Memoret e jashtme.
- Pajisjet hyrëse dhe dalëse. Teknologjitë e reja të pajisjeve *I/O*.
- Portat, kabllot, konektorët dhe përshtatësit.
- Montimi, konfigurimi dhe startimi i kompjuterit.
- Printerat, skanerat, videoprojektorët.
- Shërbime riparimi/mirëmbajtjeje të pjesëve përbërëse të kompjuterit.

5. LËNDA: Sistemet operative (108 orë mësimore)

Kodi: L-26-680-24

Klasa 10: 2 orë në javë x 36 javë = 72 orë mësimore (36 orë Teori + 36 orë Praktikë)

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- shpjegojnë rolin e një sistemi operativ;
- shpjegojnë llojet, funksionet dhe objektivat e sistemeve operative;
- shpjegojnë klasifikimin e sistemeve operative (p.sh., *batch processing, time-sharing, distributed*);
- dallojnë sistemet operative me licensa dhe *open source*;
- shpjegojnë sisteme të ndryshme operative, si *Windows etj.*;
- instalojnë sistemin operativ *Windows* duke iu përshtatur kërkesave - *requirements, partitioning, boot process, dhe installation options*);
- konfigurojnë sistemin operativ *Windows* sipas detajimeve të përcaktuara në (*control panel, system settings, user accounts, and security settings*);
- menaxhojnë shërbimet në sistemin operativ *Windows* si: përditësimi i softuerit, administrimin e shërbimeve, zgjidhja e problemeve të zakonshme *updating software, managing services, troubleshooting common issues*;
- optimizojnë performancën e konfigurimeve specifike;
- vlerësojnë efikasitetin e sistemeve të ndryshme operative për fusha specifike të aplikimit;
- shpjegojnë procesin e instalimit, *upgrade*-imit dhe migrimit të sistemit të serverave;
- tregojnë procesin e krijimit, menaxhimit dhe ruajtjes së imazhit të diskut;
- kryejnë instalimin dhe konfigurimin e *DNS (Domain Name System)* Server dhe politikat e *DNS*;
- shpjegojnë sistemin e shfrytëzimit *Windows Server* për nga ndërtimi dhe përdorimi;
- shpjegojnë menaxhimin e *Windows Server Core* me anë të komandave dhe caktimin e roleve në server;
- shpjegojnë strukturën logjike, objektet, njësitë organizative (*OU*) dhe strukturën fizike të *Active Directory (AD)*;

- shpjegojnë menaxhimin e *DNS* dhe *DHCP* (*Dynamic Host Configuration Protocol*) me *Windows Server*;
- dallojnë llojet e ndryshme të konteinerave në *AD*;
- dallojnë llojet e grupeve dhe rregullat për krijimin e tyre;
- krijojnë llogari të përdoruesve dhe kompjuterave në *AD*;
- shpjegojnë rolin e politikave të grupeve dhe njësive organizative;
- shpjegojnë krijimin dhe menaxhimin e politikave të grupeve;
- kryejnë implementimin e *Active Directory Certificate Services*;
- planifikojnë, zbatimin dhe administrimin e politikave të thjeshta të grupit;
- kryejnë instalimin, konfigurimin dhe implementimin i *Hyper-V* dhe *virtual machine*;

2. Përmbajtjet:

- Sistemet operative të kompjuterave. Llojet dhe versionet.
- Funksionet dhe objektivat e sistemeve operative.
- Klasifikimi i sistemeve operative sipas (p.sh., *batch processing*, *time-sharing*, *distributed*).
- Përdorimi i sistemeve operative me licenca dhe *open source*. Dallimet ndërmjet tyre.
- Procedurat e instalimit të sistemit operativ *Windows* (*requirements*, *partitioning*, *boot process*, dhe *installation options*).
- Konfigurimi i sistemit operativ *Windows* (*control panel*, *system settings*, *user accounts*, and *security settings*).
- Menaxhimi i sistemit operativ *Windows*, përditësimi dhe *Upgrade*-imi i sistemeve si dhe monitorimi dhe mirëmbajtja (*updating software*, *managing services*, *troubleshooting common issues*).
- Optimizimi, veçoritë e efikasitetit të sistemeve të ndryshme operative.
- Instalimi, *upgrade*-imi dhe migrimi i serverave.
- Krijimi, menaxhimi dhe ruajtja e *disk image* për shpërndarje.
- Konfigurimi i disqeve dhe volumeve. Implementimi i *server storage*.
- Instalimi dhe konfigurimi i *DNS Servers*. Krijimi dhe konfigurimi i *DNS* Zonës, Rekordet dhe politikat e *DNS*.
- *Windows Server*. Llojet e sistemeve *Windows Server* dhe kërkesat standarde për instalim dhe përdorim.
- Menaxhimi i *Windows Server Core* duke përdorur komandat. Rolet dhe veçoritë.
- Instalimi dhe konfigurimi i *Windows Server*. Menaxhimi i *DNS* dhe *DHCP* me *Windows Server*.
- Instalimi dhe konfigurimi i *Active Directory Domain Services*.
- Instalimi dhe konfigurimi i *domain controllers*.
- Krijimi dhe menaxhimi i llogarive të përdoruesve dhe kompjuterave në *Active Directory*.
- Krijimi dhe menaxhimi i grupeve dhe njësive organizative në *Active Directory*.
- Konfigurimi i autentifikimit të shërbimeve dhe politikat e llogarive.
- Krijimi dhe menaxhimi i politikave të grupeve.
- Implementimi i *Active Directory Certificate Services*.
- Instalimi, konfigurimi dhe implementimi i *Hyper-V*.
- Konfigurimi i makinës virtuale.

Klasa 11: 1 orë në javë x 36 javë = 36 orë mësimore (36 orë Praktikë)

1. Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- përdorin sistemet operative *open source*;
- përdorin versione të ndryshme të sistemit operativ *Linux*;
- përdorin sistemin operativ *Linux* (instalues *GUI (Graphical user interface)*, instalues i bazuar në tekst, konfigurime me nisje të dyfishtë);
- instalojnë sistemin operativ *Linux* sipas kërkesave;
- përdorin ndërfaqen e linjës së komandës të sistemit operativ *Linux* (komandat bazë, navigimi i sistemit të skedarëve, manipulimi i skedarëve dhe menaxhimi i përdoruesit);
- konfigurojnë sistemin operativ *Linux* (redaktimi i skedarëve të konfigurimit të sistemit, menaxhimi i paketave me menaxherët e paketave (p.sh. *apt, yum*) dhe administrimi i përdoruesve/grupit);
- përdorin automatizimin dhe shell scriptin në sistemin operativ *Linux*;
- interpretojnë parimet e arkitekturës dhe dizajnit të sistemit operativ *macOS (Macintosh Operating System)*;
- instalojnë sistemin operativ *macOS* duke patur parasysh (kërkesat, rikuperimi i *macOS* dhe opsionet e instalimit);
- instalojnë sistemin operativ *macOS* sipas preferencave dhe cilësimeve të sistemit *macOS* (konfigurimi i llogarive të përdoruesve, cilësimet e sigurisë dhe opsionet e aksesueshmërisë);
- menaxhojnë aplikacionet në *macOS* (instalimi, përditësimi dhe çinstalimi i aplikacioneve);
- përdorin karakteristikat specifike të *macOS* (kërkimi në *Spotlight*, kopje rezervë të *Time Machine*, integrimi *iCloud*);

2. Përmbajtjet:

- Sistemet operative *opensource*;
- Versione të ndryshme të sistemit operativ *Linux* (p.sh., *Ubuntu, CentOS, Debian*);
- Metodatat e instalimit të sistemit operativ *Linux* (instalues *GUI*, instalues i bazuar në tekst, konfigurime me nisje të dyfishtë);
- Ndërfaqja e linjës së komandës të sistemit operativ *Linux* (komandat bazë, navigimi i sistemit të skedarëve, manipulimi i skedarëve dhe menaxhimi i përdoruesit);
- Detyrat e konfigurimit të sistemit operativ *Linux* (redaktimi i skedarëve të konfigurimit të sistemit, menaxhimi i paketave me menaxherët e paketave (p.sh. *apt, yum*) dhe administrimi i përdoruesve/grupit);
- Automatizimi dhe shell scripti në sistemin operativ *Linux*;
- Pasqyrë e parimeve të arkitekturës dhe dizajnit të sistemit operativ *macOS*;
- Procedurat e instalimit (kërkesat, rikuperimi i *macOS* dhe opsionet e instalimit);
- Preferencat dhe cilësimet e sistemit *macOS* (konfigurimi i llogarive të përdoruesve, cilësimet e sigurisë dhe opsionet e aksesueshmërisë);
- Menaxhimi i aplikacioneve në *macOS* (instalimi, përditësimi dhe çinstalimi i aplikacioneve);

- Karakteristikat specifike të *macOS* (kërkimi në *Spotlight*, kopje rezervë të *Time Machine*, integrimi *iCloud*;

6. LËNDA: Programet aplikative (108 orë mësimore)

Kodi: L-26-681-24

Klasa 10: 3 orë në javë x 36 javë = 108 orë mësimore (36 orë Teori + 72 orë Praktikë)

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- shpjegojnë programe të zakonshme aplikative si programet e tekstit dhe *spreadsheets*, softuerët për prezantime, dhe sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave;
- demonstrojnë teknikat dhe mjetet e nevojshme për të krijuar, redaktuar, dhe formatuar dokumente të ndryshme në mënyrë interactive;
- analizojnë të dhënat duke përdorur softuerë për *spreadsheets*;
- përgatitin prezantime tërheqëse dhe të efektshme;
- përshkruajnë veçoritë e automatizimit të ofruara nga programet aplikative;
- organizojnë simulime të situatave të ndryshme që kërkojnë përdorimin e programeve të zakonshme aplikative për të zgjidhur problemet;
- krijojnë mini-projekte kreative duke përdorur programet aplikative në mënyra të reja dhe innovative;
- përshkruajnë praktikën e sigurisë së të dhënave;
- shpjegojnë mjete dhe teknika të sigurisë në programe aplikative;

2. Përmbajtjet:

- Programet si *Microsoft Word* dhe *Google Docs* për krijimin dhe menaxhimin e dokumenteve tekstuale.
- Programet si *Microsoft Excel* dhe *Google Sheets* për analizë dhe menaxhim të të dhënave numerike.
- Programet si *PowerPoint* dhe *Google Slides* për krijimin e prezantimeve vizuale.
- Sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave duke përdorur softuere si *Microsoft Access* dhe *MySQL (Structured Query Language)*;
- Praktikën e sigurisë së të dhënave.
- Mjetet dhe teknikat e sigurisë në programe aplikative.

7. LËNDA: Programimi dhe inxhinieria e softuerit (700 orë mësimore) Kodi: L-26-682-24

Klasa 10: 5 orë në javë x 36 javë = 180 orë mësimore (72 orë Teori + 108 orë Praktikë)

1. Njohuritë dhe Shprehitë:

Nxënësit do të jenë të aftë të:

- kryejnë instalimin e mjedisit (*IDE-ve Integrated Development Environment*) për zhvillimin e aplikacionit;
- përzgjedhin framework-et e duhura për zhvillimin e aplikacionit;
- listojnë dhe klasifikojnë gjuhët programuese;

- listojnë hapat për ndërtimin e një programi;
- përcaktojnë algoritmet dhe funksionet kryesore;
- ndërtojnë algorimet dhe pseudokodet;
- përcaktojnë kompilatorin dhe interpretuesin;
- përcaktojnë fazat e kompilatorit;
